

ONOMASTIKA NË VEPRËN E THIMI MITKOS

Onomastika e folklorit në veprën e Thimi Mitkos është një nga pjesët më të rëndësishme dhe njëherazi, shumë e pasur me emra të përveçëm vendesh e njerëzish, toponime e antroponime që janë pasqyruar në veprën e tij. Në veprën e Thimi Mitkos, përpos onomastikës, gjenden elemente logjike, etike, psikologjike, fizike e metafizike. Në lidhje me këtë, Thimi Mitko sjell citate për të mbështetur mendimet, duke përmendur emra autorësh e vendesh në shkrime të ndryshme. Onomastikën e veprës së Thimi Mitkos do ta paraqes në formë fjalori, sipas rendit alfabetik, në mënyrë që lexuesi apo studiuesi, duke i parë të renditura, ta ketë më të lehtë kërkimin dhe gjetjen e elementeve onomastike, që i duhen për t'i njohur ose për t'i studiuar.

Onomastika e nxjerrë nga vepra e Thimi Mitkos

Në këtë shkrim jemi marrë me onomastikën (emra të përveçëm vendesh e njerëzish- toponime e antroponime) që janë pasqyruar në veprën e Thimi Mitkos. Këta emra vetjakë (personalë) me vendet e tyre na njohin edhe me kulturën e Thimi Mitkos, natyrisht brenda rrethanave të kohës e të hapësirës së tij. Onomastika në veprën e Thimi Mitkos përmban emra të përveçëm, që i përkasin jo vetëm kohës së vjetër të Lindjes së Mesme, por edhe greqishtes së vjetër e latinishtes. Emrat e përmendur nga Thimi Mitko, kanë interes gjuhësor për t'u renditur, sepse në një mënyrë a në një tjetër krijojnë mundësi që të bëhen vrojtme të ndryshme, ndër të cilat edhe vrojtme gjuhësore për nga përshtatja fonetike e tyre në gjuhën shqipe, për nga burimi e të tjera si këto. Një pjesë e onomastikës përmbledh toponime e antroponime, që lidhen me vetë Thimi Mitkon dhe veprën e tij ose me vendin, popullin e gjuhën tonë, çka merret si dokumentim edhe nga ana historike. Po ndalemi në disa pikësnyime që kemi pasur.

I pari pikësnyim, ka qenë për t'i paraqitur në formë fjalori, sipas rendit alfabetik, në mënyrë që lexuesi apo studiuesi, duke i parë të renditur, ta ketë më të lehtë kërkimin dhe gjetjen e elementeve onomastike, që i

duhen për t'i njohur ose për t'i studiuar. E dyta, është se autori i shkruan antroponimet e toponimet në rregull, po me atë grafi të përdorur për fjalët shqipe e po me atë morfologji shqipe, në lakimin e emrit, atëherë edhe ne këtu do t'i përmbahemi këtij rregulli. Kështu do të veprohet edhe për njësitë e onomastikës. E treta, ka të bëjë me ato raste, kur emri i përveçëm del disa herë për të njëjtin njeri ose vend, me të njëjtën trajtë fonetike. Në këto rrethana ai emër është shkruar vetëm një herë. E katërta, i takon kontekstit, në të cilin qëndron si element onomastik, prandaj që të dihet se ç'është ai emër i përveçëm, toponim ose antroponim e bashkë me ndonjë karakteristikë tjetër, që mund të ketë, janë nxjerrë shprehje e citate më të gjera ose më të ngushta, ashtu siç janë lexuar ato shprehje te Thimi Mitko në veprën e tij. Thimi Mitko e hartoi veprën e tij në mars të vitit 1878, kur po zhvilloheshin ngjarje historike vendimtare, prandaj ka shtruar në të probleme të rëndësishme politike dhe kulturore¹. Me krizën lindore të viteve 1877-1878, qeveritë shoviniste të Serbisë dhe të Malit të Zi, si dhe Bullgaria e madhe, e krijuar nga Rusia me Traktatin e Shën Stefanit, do të realizonin planet e tyre grabitqare në kurriz të tokave shqiptare. Përpara këtij rreziku, udhëheqësit e lëvizjes shqiptare e panë të nevojshme të hynin në lidhje me qeverinë greke për formimin e një aleance për të përballuar ekspansionin e shteteve sllave, që vinte në rrezik edhe interesat e Greqisë. Këtij qëllimi i shërbyen edhe kontaktet që pati Abdyl Frashëri² me përfaqësues të qeverisë greke në vitin 1877 dhe në janar të vitit 1878. Një mendim të tillë shpreh këtu edhe Thimi Mitko, derisa vetë ngjarjet treguan qëndrimin armiqësor antishqiptar të politikës greke ndaj Shqipërisë. Vetë Thimi Mitko në hyrjen e “Blëtës” i shihte qartë rreziqet që i vinin popullit shqiptar nga rrethet shoviniste greke të Athinës dhe politika kishtarë e Patriakanës së Stambollit, që në fakt e bënë të pamundur një bashkëpunim të tillë.³

Vepra e Thimi Mitkos është e mbushur me lloj-lloj ngjarjesh nga fusha të ndryshme, si: kulturore, historike, gjeografike, politike, folklorike etj. Normalisht që edhe onomastika në veprën e Thimi Mitkos është shumë e pasur.

Vepra leksikografike e Mitkos, e panjohur deri vitet e fundit, nuk i shërbeu dot procesit të pasurimit e të konsolidimit të shqipes letrare. Por

1 Thimi Mitko, *Vepra*, Tiranë, 1981, f. 63.

2 Në fund të vitit 1877, Abdyl Frashëri (atëherë deputet i Janinës në parlamentin e dytë osman), u zgjodh kryetar i Komitetit Qendror për Mbrojtjen e të Drejtave të Kombësisë Shqiptare, që u formua në Stamboll (*Komiteti i Stambollit*).

3 Thimi Mitko, *Vepra*, Tiranë, 1981, f. 64.

ajo ka në vetvete vlera të shumta shkencore për gjuhësinë shqiptare. Ajo i shërben historisë së dokumentimit të fjalëve dhe të pasurimit të leksikut me neologjizma e huazime, historisë së zhvillimeve semantike, historisë së ngulitjes së normës letrare drejtshkrimore e gramatikore, historisë së shqipes letrare në përgjithësi, marrëdhëniet e shqipes me gjuhët fqinje e sidomos me greqishten si gjuhë shkrimi, përpjekjeve për krijimin e termave, njohjes më të plotë të frazeologjisë dhe fjalëve të urta, toponimisë etj. Fjalori i Kristoforidhit⁴ dhe fjalori i Mitkos qëndrojnë përkundrajt njëri-tjetrit, si dy vepra plotësuese, duke na dhënë të dyja së bashku një pasqyrë më besnike të leksikut të shqipes në dhjetëvjeçarët e fundit të shek. XIX. Një temë me interes do të ishte studimi përfaqës i këtyre fjalorëve.

Onomastikën e Thimi Mitkos do ta paraqes vetëm për pjesën lirike, që përfshin: këngë të vegjëlish, këngë për festat popullore të motmotit, këngë dashurie, këngë dasme e kurbeti, vaje e këngë të pavajëshme, të ndryshme, balada.

Onomastika në veprën e Thimi Mitkos:

Arbër/i: *Arbër-o, gjarpër-o, leshkorra, bir-o!*

Ali pashë Janinë/a: *Prej Ali pashës Janinës po i marin nuse qenit, gruen e Ago Omerit.*

Ago Omeri: *Ç` peng po len, Ago Omerit?*

Arapistan/i⁵: *U djegsh o Arapistan.*

Armerosë: *Humbe mëndjen e s`e gjen, o budall i Armerosë.*

Alush Tabaku: *Jam e Alushë tabakutë.*

Avram/i: *Qir Avramit ushtri, fill i kllapodanit.*

Angjelinë/a: *Janin`e mjera Janinë emërin e ke Angjelinë.*

Artinë: *Çë kej Artinë, ajo mbjovi apo thinjë.*

Avionë: *Sa mbuavë k`Avuona.*

Adile: *Tundu, moj, se të ka hie, posi dielli kur bie.*

Adem/i: *Qaj, mok Katerinë, qaj për Ademanë.*

Baba Ferro: *O sulltan, me pisqoll`e jatagan.*

Berat/i: *Ujë kanë verë s`kanë, levend i Beratitë.*

Çelo Picari: *O kalem` i kallamarit, pisqoll`e Çelo Picarit.*

Dukagjin/i: *Mbush kupen me Dukagjin moj bija ime.*

4 Vepra themelore e Kostandin Kristoforidhit, për të cilën punoi gjithë jetën, është *“Fjalori i gjuhës shqipe”* me 11 675 leksema. Ai është i përpiluar në toskërishte me alfabet të mbështetur në shkronja greke dhe i botuar më 1904 në Athinë.

5 Arabia.

- Dudë/a:** *Moj dudë, Dudileja, buzëkarafleja.*
- Dudusheja:** *Moj Dudë, Dudesheja, buzë qengjrusheja.*
- Dudileja:** *Dudileja, buzëkarafleja.*
- Dunavecnë/a:** *Lumtë këmb` e kalit bardhë.*
- Durrësë:** *Kali vajti Durrësë, në katund të pulësë.*
- Dush/i:** *Tir, nanja e Dushit.*
- Dimopull/i:** *Solli mjalt` edhe recinë.*
- Dhimitraq/i:** *Dhimitraq, o Dhimitraq, u sëmure e s`pat ilaç.*
- Englitrë⁶:** *U bëfsha frëng me kapellë lir` e frëngut nd` Englitrë.*
- Elen/i:** *I muarë me lemona. Elinë, çë kej Artinë.*
- Elbasan:** *Duda ish prej Elbasani.*
- Ëlli:** *Rri rri shën Ëlli.*
- Ferro:** *O sulltan me pisqoll` e jatagan.*
- Feiz/i:** *Ky Feizi burrë, që hoqi jorganë e çoban.*
- Gramosi/i:** *Nikulica dhe Gramosi ndë mest na rënëke Ristosi.*
- Guçëja:** *Të më lozë Guçëja, faqekolopuçëja.*
- Gjirokastrë/a:** *E kur vajçë Gjirokastrë, kungull pashë ndë çdo bashtë.*
- Gjin/i:** *Gjini erth e shkoi.*
- Gjika:** *Gjika vajti mbë të parë, gjeti Kostandin` e vrarë.*
- Gjeraqinë/a:** *Flytyroi një Gjeraqinë, me zile nëpër këmbë.*
- Hajçëja:** *Hajçëja, i biri i Puçësë, foli faqekuqesë.*
- Hasan Kolonja:** *Hasan bej, Hasan Kolonja, mos të turpëronjë zonja.*
- Hasan bej:** *Hasan bej, Hasan Kolonja, mos të turpëronjë zonja.*
- Hysen beu:** *Hysen beut me pikë ndë ballë.*
- Itali/a:** *Po miri thelë frëngjinë, Trieshtën e Italinë.*
- Ilia:** *Ilia, Ilia.*
- Ismail/i:** *Me takëme, o sheh Islami me mëndje.*
- Ibrahim beu:** *Shan` e Ibrahim beut shtat vjet beronjë.*
- Ismail beu:** *Vran` Ismail bejnë.*
- Janinë/a:** *Janin` e mjera Janinë emërin e ke Angjelinë.*
- Jaçë/ja:** *Moj` e bij` e Jaçësë karafil pas faqesë.*
- Janjesë/a:** *Vranët na ish, na binte shi, ndër malet e Janjesë.*
- Kapokudhës Qirhati:** *Kapokudhës Qirhati, po të vrau i Kallarati.*
- Karbunarë⁷:** *Ç`deshe ti ndë Karabunarë.*
- Kullur/i:** *Vjen një kartë ka Kulluri.*
- Kollonatë:** *I biri i Kollonatësë.*
- Kiçonë:** *Çanëza me Kiçonë luajnë restiçonë.*

6 Anglia e sotme.

7 Fshat në Vlorë.

Kostandinkë/a: Paç edhe jatronj të mijtë, të gjorin Kostandinkë.
Kamenicë/a: Ç`deshe në Kamenicë.
Kolonjëse⁸: Kali mari udhënë, udhënë e Kolonjëse.
Krisht/i: Ndek farkonteji shpatënë, të zotit Krisht.
Koikua⁹ (Mal në Përmet): Dolle mbi Koikua, seç pe Libivanë.
Korfuz/i: Më vjen si gjemi Korfuzi.
Katerinë/a: Qaj, mok Katerinë, qaj për Ademanë.
Kostandin/i: Gjika vajti mbë të parë, gjeti Kostandin`e vvarë.
Kallarati/i: Kapokudhës Qirhati, po të vrau i Kallarati.
Lazare: Lazare o Lazare, ngreu, ngreu, se u err.
Lulushe/ja: Të gënjeu, Lulesheja me një shami mollë.
Lamçesë: Pisqollat e Lamçesë i mban mesi i Hajçesë.
Lazër/i: Lazëri që bëre lazuarë.
Libivanë, (Fshat në Përmet) Dolle mbi Koikua, seç pe Libivanë.
Lackë/a: Ndë krua të Lackës t`u gjet lahuria.
Lepsinë/a: Dollli barka në Lepsinë.
Limotogë: Haj vemi për Limotogë.
Llazëri: Llazëri, shën Llazëri.
Mirëdita¹⁰: Mirëdita moj kadënë, mirë sot, mirë motë.
Misir/i¹¹: Ky Misiri fort i largë.
Manusho: Ballët moj manusho.
Mahmut beu: Me takëme, o sheh Islami me mëndje.
Mitro Dedë Duka: U vra Mitro Dedë Duka, treqind dhen i la kërruta.
Mëria¹²: Lutij zonjës shën Mëri.
Manastire: Erç edhe të kërkova shpirt, o moj Manastire.
Majan agai: U bë ulërimë vajit, than` u vra Majan agai.
Mane Bendua: Mane Bendua seç, i priti mun në zembrëtë i goditi.
Marinë/a: Pa pyetni Marinë, sa dhallë me barrë.
Malishovë/a: Aman përrënj me dëborë. Që Sinic` e Malishovë.
Nikulica: Nikulica dhe Gramosi ndë mest na rënëke Ristosi.
Nazif/i: O Nazif, o budalla bjeri fyellit kaba.
Ngjelinë/a: Ngjelino buzëburbuqe, ti s`m`i pate këto huqe.
Ohrie¹³: Të solla ty ca molla, ca molla pe Ohrie.

8 Komunë në Shqipëri.

9 Koikua, mal në Përmet.

10 Mirditë, Krahinë në Shqipëri.

11 Misiri apo Egjipti i sotëm.

12 Mëria. Shën Mëria.

13 Ohri, qyteti i Ohrit.

Omer/i: *O Omer ago i shkretë.*

Povëlo: *Dili o shokë se do dalëmë, o to piqemi Povëlo.*

Petro beu: *I apim nese dudinë, të bijën e Petro beut.*

Pjetrë: Triko, *i shën Gjini se na vjen zot` i shën Pjetrë.*

Pjetri: *I shën Pjetri na afëroi.*

Puçeja: *Hajçeja, i biri i Puçesë, foli faqekuqesë.*

Përmet/i: *Çupë pe Përmeti, nuse në Janinë.*

Poliçanë¹⁴: *Sipër, mbë Poliçanë.*

Pirgopull/i: *Çana me Dimopullin shajtin Pirgopullin.*

Qafëkrabë: *Kapërxeve Qafëkrabë, harrove nan` edhe babe.*

Qamil/i: *Na prishe nga mëntë, kopil` e Qamilit!*

Ruki/eja: *Hajde, haj, hank` Rukija.*

Rexhep/i: *Krushqit prapa malitë, Rexhep, hypi kalitë.*

Ristos/i: *Nikulica dhe Gramosi ndë mest na rënëke Ristos.*

Spanjë/a: *Prej asaj së zesës Spanjë.*

Sinicë/a: *Aman përrënj me dëborë. Që Sinic` e Malishovë.*

Sulo Kafexhiu: *Një i Sulo Kafexhiut.*

Sulejman/i: *Qeni lihte ham ham as e prit, o Sulejman.*

Selanik/u: *Pllumbi na iku, shkoi nga Selaniku.*

Stamboll/i: *O sheh Islam` i Stambollit.*

Sparimiosë/a: *Ti u bure për gumenë, në Manastir të Sparmiosë.*

Starovë/a: *Shkon e vete në Starovë.*

Sofkë/a: *Vate dielli një copë seç` na shkon milonja Sofkë.*

Shën Elli: *Rri rri shën Ëlli.*

Shën Mëria: *Lutij zonjës shën Mëri.*

Tomor: *Sa lule ndë Tomor, aqe nuse ndë hobor.*

Trieshtë/a: *Po miri thelë frëngjinë, Trieshtën e Italinë.*

Tafil/i: *E shkurtër` po si Tafili.*

Tatushan/i: *Tatusha, moj meslangore, pse s`na rrëfen, se nga dole?*

Testemel/i: *Qesh e lot, ç`ke lule, që qanë me lot?*

Telha beu: *Vranë Telha bejnë.*

Ylqin/i¹⁵: *Banu burre` e shkojm` Ylqin.*

Velikoja: *Velikoja xbrizste malit.*

Vlorë/a: *Kur më vëje mbë kurorë, po si Xhafer beu në Vlorë.*

Vidi: *Në Stamboll e në Vidin, fort po ishte qe ky trim.*

Vezir/i¹⁶: *Vasha me çbuk Veziri, lesht e saj si fqoll liri.*

14 Poliçani, qytet i vogël në pjesën qendër-jugore të Shqipërisë.

15 Ulqini i sotëm.

16 Nëpunësi më i lartë qeveritar në Perandorinë Osmane dhe në disa vende të Lindjes së Afërt; titull

Vullakë: *E shkreta Vullakë, ti u bëfsh fëngjill e flakë.*

Vasil Tereziu: *Vasil Tereziu i tha: na e zënëkan, o Telha.*

Vrion/i: *Kemi hall me Vriono.*

Xhafer beu: *Kur më vëje mbë kurorë, po si Xhafer beu në Vlorë.*

Xhemil/eja: *Moj Xhemil' e kujtia je? Jam e Alush Tabakutë.*

Zylyftar pashai: *Than` u vra Majan agai, q` ish si Zylyftar pashai.*

Zenel agai: *Dy plumba me tel për Zenel aganë.*

Zenel Çareja: *Zenel Çareja shah ty, kuj, kuj, kuj të ke qen.*

Përfundim

Thimi Mitko është njëri nga personalitet më të veçanta të kulturës shqiptare, dhe një nga më të dalluarit e Rilindjes sonë Kombëtare. Kontributi i tij është i jashtëzakonshëm për folkloristikën shqiptare. Thimi Mitkon lirisht mund ta quajmë babain e folklorit shqiptar. Njëkohësisht, ai u dallua edhe si një nga mbledhësit më të çmuar të leksikut të gjuhës shqipe. Mitkoja ishte njohës i shkëlqyer i gjuhës dhe i kulturës greke, sepse ai u formua si intelektual i mirëfilltë në shkollat greke, por duke mos harruar asnjëherë gjuhën, kulturën, folklorin dhe historinë shqiptare. Në këtë punim, objekt studimi kemi onomastikën e veprës së tij. Onomastika në veprën e tij është mjaft e pasur. Përmbledhja folklorike e Mitkos u botua në vitin 1878. Ajo përmban një fjalor me rreth 1000 fjalë. Fjalori u hartua për të vënë në dukje fjalët e huaja që përmbanin tekstet folklorike të përmbledhjes. Fjalori i tij ka shumë fjalë me origjinë perse, turko-arabe, greqizma, sllavizma.

Duke pasur parasysh kohën kur u shkrua “Bleta shqiptare”, si dhe nivelin e lëvrimin të saj në atë periudhë, lirisht mund të themi se gjuha e Thimi Mitkos ishte gjuhë e pastër burimore shqipe. “Bleta shqiptare” ka mjaft toponime, mikrotoponime, antroponime, patronime, trionime, etnonime, hidronime, oronime, nofka, çka e bëjnë onomastikën e tij shumë të pasur. Toponimia në veprën e Mitkos zë një hapësirë të madhe. Në të përfshihen shumë emra të qyteteve, fshatrave, lumenjve, fushave, maleve të disa shteteve si në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, Greqi, Mal i Zi, gjithsej 215 toponime. Në “Bletën shqiptare” gjithsej kemi 996 antroponime dhe patronime.

i pashallarëve vendës që kanë sunduar në Shkodër dhe në Janinë, në shekujt XVIII dhe XIX. Veziri i madh, kryeministri i ish-perandorisë turke. Veziri i Shkodrës (i Janinës).

Thimi Mitko kishte letërkëmbime me intelektualët më të shquar të Rilindjes sonë Kombëtare, si me Naim dhe Abdyl Frashërin, Jeronim de Radën, Jani Vreton, Dora d' Istrian, Kristo Luarasin, Dhimitër Kamardën, Nikolla Naçon. Thimi Mitko realizoi mbledhjen e leksikut të gjuhës shqipe në forma të ndryshme: a) nga kontaktet me bashkatdhetarët e tij në Egjipt; b) nga udhëtimet dhe takimet e tij të shpeshta që kishte me shqiptarë në Rumani, Bullgari, Turqi; c) me letërkëmbime që realizonte me rilindës dhe patriotë për mbledhjen e leksikut të shqipes.

Bibliografia

1. Akademia e Shkencave e Shqipërisë, *Fjalor Enciklopedik Shqiptar*, Tiranë, 2008.
2. Bedri Dedja, *"Tradita dhe probleme të letërsisë shqipe për fëmijë"*, Tiranë, 1971.
3. Eqrem Çabej, *Studime gjuhësore*, Prishtinë, 1976
4. Robert Elsie, *Biographical Dictionary of Albanian History*, 2012.
5. Jorgo Bullo, *"Magjia dhe magjistarët e fjalës"*, Tiranë, 1998.
6. Jeronim de Rada, *Antologia albanese*, Napoli, 1896.
7. Mahir Domi, *Folkoristit të parë shqiptarë: Thimi Mitko dhe Spiro Dine*, "Letërsia jonë" IV, 1950.
8. Rexhep Qosja, *Historia e letërsisë shqipe (Romantizmi I)*, Prishtinë, 1984.
9. Thimi Mitko, *Vepra*, Akademia e Shkencave dhe Arteve e Shqipërisë, Tiranë, 1981.